

OPINION

Mbi pyetëtorin e përcjellë për konsultim nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për monitorimin e veprimtarive të subjekteve zgjedhore gjatë fushatës zgjedhore

Përfaqësuesit e KRIIK në takimin e datës 13/10/2020 me Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve, ndër të tjera shprehën nevojën për ndërmarrjen e një procesi konsultativ në funksion të miratimit të akteve rregullatore¹. Kjo kryesisht për shkak të mungesës së konsultimit publik në hartimin dhe miratimin e akteve amenduese gjatë procesit të reformës zgjedhore si dhe për shkak të rolit legjislativ që i është dhënë KQZ-së nga legjislatori për miratimin e një tërësie aktesh të rëndësishme në rregullimin e procesit zgjedhor.

Gjithashtu, një tjetër vlerë e shtuar e këtij konsultimi të ndërmarrë, është mundësia për më shumë kontribut, qasje më proaktive si dhe marrje e zhvillim përgjegjësish më të mëdha të aktorëve vendas në mbarëvajtjen e proceseve zgjedhore dhe në përgjigje të nevojave adekuate të zhvillimit demokratik të vendit.

Në vijim të këtij qëndrimi, KRIIK shpreh konsideratën e tij për nismën e ndërmarrë dhe për pyetëtorin në fjalë të përcjellë nga KQZ-ja për konsultim. Sjellje kjo që vjen në përputhje me detyrën madhore që i është ngarkuar këtij Institucioni si “kontrolluesi i vetëm” i tërë veprimtarisë financiare të partive politike dhe i fushatave zgjedhore.

Nga ana tjetër, kjo sjellje përbën një hap pozitiv dhe shpresëdhënës në reformimin e sjelljes së institucionit dhe të funksionimit të tij në këtë dekadë të re, në përputhje me aspiratat e Marrëveshjes Politike të 5 qershorit 2020, për ndërtimin dhe konsolidimin e një institucioni të pavarur, zbatues katërcipërisht i Kushtetutës dhe Ligjit në zhvillimin dhe sigurimin e proceseve zgjedhore me integritet.

KRIIK shpreh qëndrimin se instrumenti i monitorimit të veprimtarive elektorale gjatë fushatës zgjedhore mbart një rëndësi madhore drejt formësimit dhe konsolidimit të një mekanizmi të plotë kontrolli ndaj financimit që ushqen dhe bën të mundur këto veprimtari.

Ky mekanizëm, rezultat i Marrëveshjes Politike të 18 Majit 2017, i zbatuar në dy procese zgjedhore të vitit 2017 dhe 2019-të, më parë gjente rregullim ligjor tek Ligji “Për partitë politike”. Me ndryshimet e fundit të Kodit Zgjedhor dhe abrogimit të dispozitave të Ligjit “Për Partitë Politike”, rregullimi i këtij procesi kryhet tashmë vetëm nga Neni 92/4 i Kodit Zgjedhor.

Gjatë miratimit të këtyre ndryshimeve, të dakordësuara edhe me opozitën jashtëparlamentare si pjesë e paketës amenduese në zbatim të Marrëveshjes Politike të 5 qershorit, eksponentë të mazhorancës parlamentare siguruan se, jo vetëm janë transpozuar tërësisht parashikimet e mëparshme në Ligjin “Për partitë politike”, por janë përmirësuar më tej ato duke ofruar një transparencë akoma më të madhe.

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailing address:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

¹ KRIIK, [Deklaratë](#), datë 13.10.2020 “*Mirëfunksionimi i KQZ-së së re si domosdoshmëri, jo vetëm për suksesin e përgatitjes së procesit të ardhshëm zgjedhor, por edhe për jetësimin e aspiratës së marrëveshjes politike të 5 qershorit*”.

Në këtë kuadër dhe në funksion të këtyre aspiratave, pritet që KQZ-ja të zhvillojë maksimalisht përgjegjësitë e saj në formësimin dhe konsolidimin e metëjshëm të mekanizmit dhe instrumentave përbërës, të provuara në zgjedhjet e 2017-ës dhe 2019-ës, duke siguruar ligjzbatimin prej partive politike, të cilat nuk janë as më pak dhe as më shumë se detyrimet ligjore që ka në raport me përdorimin e mjeteve financiare çdo subjekt juridik apo edhe person fizik në Republikën e Shqipërisë.

Një qasje e tillë e pakompromis ndaj financave të partive politike, përpos se do t'i japë fund vatrës së moszbatimit të ligjit dhe pandëshkueshmërisë, forcon më tej fuqinë e shtetit përballë rreziqeve madhore të kapjes së pushteteve apo edhe vetë tij nga interesat e paligjshme.

Thënë gjithë sa më sipër vlen të theksohet sërish se rëndësia e instrumentit të monitorimit qëndron në ofrimin e një transparence më të lartë të veprimtarisë financiare të subjekteve zgjedhore dhe në atë se ajo përbën "hallkën munguese" në mekanizmin e kontrollit të veprimtarisë financiare.

Në vijimësi, vetë aktorët politikë apo përfaqësuesit institucionalë kanë parashtruar se auditimi i vetëdeklarimit ka qenë një proces fiktiv. Kjo për shkak se auditimi mbështetej tërësisht mbi çka vetë subjektet zgjedhore deklarojnë dhe auditimi kontabël mbetet në padijeni të gjendjes së faktit.

Ndërkohë gjetjet e dala nga monitorimi, ndër të tjera, mund t'i vijnë në ndihmë audituesit për të kontrolluar sesi janë reflektuar apo nuk janë reflektuar nga subjektet zgjedhore në dokumentacionin financiar të paraqitur.

Gjithashtu, KRIIK sjell në vëmendje të KQZ-së se gjetjet e dala nga procesi i verifikimit dhe kontrollit të veprimtarisë financiare përgjatë fushatës zgjedhore të 2019-ës, i përfunduar në mënyrë të plotë nga administrata e KQZ-së sikurse është bërë publikisht me dije², pavarësisht se nuk mundën të merreshin në shqyrtim në seancë prej trupës së KQZ-së së mëparshme, mund të vlejnjë si një hartë e mirë orientuese për përmirësimin dhe konsolidimin e mëtejshëm të mekanizmit monitorues apo edhe të formateve të deklarimit.

Përsa i përket 8 pyetjeve konkrete në Pyetësorin e përcjellë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me datë 19.11.2020 në dokumentin me titull "Përzgjedhja e monitoruesve të fushatës dhe objekti i monitorimit"

ju shprehim Opinionin e KRIIK si më poshtë vijon:

Mbështetur³ në monitorimin e proceseve zgjedhore dhe veçanërisht në atë të fundit, analizën e kryer dhe gjetjet e dala, KRIIK paraprakisht shpreh përmbledhtazi disa

² [Fjala e Kryetarit të Kryetarit të KQZ-së](#), z.Klement Zguri lidhur me Raportimin vjetor të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2019-të, në Kuvendin e Shqipërisë, datë 21/05/2020, "... Aktualisht, KQZ ka përfunduar procesin e verifikimit dhe kontrollit të raporteve, por shqyrtimi i tyre në mbledhje të KQZ-së do të zhvillohet pas normalizimit të situatës nga pandemia COVID-19, pasi mbledhjet e KQZ-së janë publike dhe kërkojnë pjesëmarrjen e shumë personave. KQZ-ja ka ndryshuar sjelljen e saj ndaj raportimeve dhe auditimeve. Ato nuk janë më formalitet, nuk bëhen më për të kaluar radhën. ..."

³ KRIIK, [Raport Monitorimi Nëntor 2018 – Shkurt 2020](#), Qershor 2020, "Sjellja ligjore dhe institucionale e institucioneve dhe aktorëve të përfshirë në procesin zgjedhor të 30 Qershorit 2019"; KRIIK/KVV, [Raport Përfundimtar Vëzhgimi Nëntor 2016 – Korrik 2017](#), Korrik 2017, "Raporti Përfundimtar i Vëzhgimit të Zgjedhjeve të 25 Qershorit 2017".

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailing address:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

vlerësime mbi procesin e monitorimit të veprimtarive elektorale. Gjithashtu, këto konsiderata janë konkluzione të dala nga një studim shkencor që organizata do të publikojë së shpejti dhe që do t'i vendoset në dispozicion edhe institucionit⁴ të KQZ-së.

Fillimisht KRIIK, në referim të **Pyetjes 8**⁵, paraqet se në pyetësin e përcjellë nuk përfshihen në shqyrtim disa çështje që, në gjykimin tonë, janë parakushte për pyetjet e shtruar në dokument dhe për të bërë të mundur monitorimin e veprimtarisë zgjedhore të subjekteve.

Në parashtrim të qëndrimit në tërësi të organizatës, sillet në vëmendje një fakt tejet i rëndësishëm. Dispozitat e Ligjit “Për partitë politike” të abroguara rregullonin një monitorim tërësor të veprimtarisë së fushatës zgjedhore nga individë ekspertë⁶ financiarë.

Në draftet e përgatitur në krye të herës nga ekspertët pranë Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore u vendos një perspektivë e re e monitorimit të fushatës nga persona me përvojë në vëzhgimit e proceseve zgjedhore⁷. Pra, qartësisht në atë draft parashikohej që monitorimi të kryhej nga përfaqësues të organizatave jofitimprurëse dhe jo nga ekspertë kontabël.

Shihet tashmë që edhe në ndryshimet e Kodit Zgjedhor, por me një frazim më kufizues, është lënë mundësia e monitorimit jo vetëm nga ekspertët kontabël, por edhe nga individë apo subjekte me ekspertizë të papërcaktuar⁸.

Kjo hapësirë e lënë nga Kodi Zgjedhor, theksohet që është e rrezikshme dhe se KQZ duhet të jetë tepër e kujdesshme në qëndrimin që do të mbajë.

Me tërë problematikat e evidentuara, ekspertët kontabël kanë treguar se gëzojnë një ekspertizë që mund të përshtatet më së miri me kërkesat për detyrën e ngarkuar, si dhe një “integritet personal e institucional” që i bën ballë presionit dhe intimidimit politik.

Për më tepër nuk gjendet asnjë arsye se përse përfaqësuesit e organizatave jofitimprurëse apo edhe individë nga shoqëria civile, sado me përvojë, mund të jenë më efikas në monitorimin e veprimtarive zgjedhore.

Në gjykimin e KRIIK, sikurse është bërë e ditur më parë përgjatë procesit të reformës zgjedhore, realizimi i një skeme të tillë nuk është aspak parimor dhe as i shëndetshëm.

⁴ Realizimi i këtij studim është mbështetur financiarisht nga Programi i Granteve të Vogla të Komisionit për Demokraci të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Shqipëri, i paraprirë nga mbi 120 intervista gjysëm të strukturuar me aktorë relavantë politikë dhe jo politikë.

⁵ Pyetja 8: *A keni sugjerime të tjera që mendoni se KQZ-ja duhet t'i marrë parasysht gjatë hartimit të aktit nënligjor mbi monitorimin e fushatës?*

⁶ Ligj Nr.8580, datë 17.02.2000, “Për Partitë Politike”, Neni 24/4 “Monitorimi i shpenzimeve të fushatës zgjedhore”, pika 1 “Jo më vonë se dita e fillimit të fushatës zgjedhore, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve emëron me short një numër të mjaftueshëm ekspertësh financiarë, për të kryer monitorimin e fushatës zgjedhore të partive politike, duke përfshirë aktivitetet, veprimtaritë dhe materialet e përdorura prej tyre gjatë fushatës zgjedhore.”

⁷ Referuar draft amendimeve të përgatitura nga ekspertët e Komisionit të Posaçëm Parlamentar të Reformës Zgjedhore: Neni 90/2 “Monitorimi i fushatës zgjedhore”, pika 1 “Jo më vonë se gjashtë muaj para datës së zgjedhjeve, KQZ-ja cakton një numër të mjaftueshëm personash për të monitoruar përmbushjen nga subjektet zgjedhore të detyrimeve në lidhje me financimin e fushatës dhe detyrimeve të tjera sipas nenit 4 të këtij Kodi. *Monitoruesit duhet të përzgjidhen nga personat me përvojë në vëzhgimin e zgjedhjeve.*”

⁸ Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Ligji Nr. 10019, datë 28/12/2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 92/4, pika 1, “Jo më vonë se gjashtë muaj para datës së zgjedhjeve, KQZ-ja cakton një numër të mjaftueshëm personash për të monitoruar përmbushjen nga subjektet zgjedhore të detyrimeve në lidhje me financimin e fushatës dhe detyrimeve të tjera sipas këtij kreu.”

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailing address:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Ajo përbën në vetvete një shtrirje të mëtejshme të sistemit të patronazhit politik në rradhët e aktorëve të shoqërisë civile, duke nxitur përplasje, minuar besueshmërinë e çdo lloj gjetjeje dhe ekspertize, si dhe duke zhbërë zërat kritikë, të pavarur dhe me integritet të shoqërisë civile.

KRIIK argumenton dhe mbështet qëndrimin se vetëm ekspertët kontabël gëzojnë ekspertizën më të afërt me kërkesën e legjislacionit dhe si të tillë profesionistë të fushës mund të përbëjnë një instrument ligjor të përshtatshëm dhe më efikas për monitorimin.

Gjithashtu, shkurtimisht përmenden si të paadresuar në pyetësonin e përcjellë edhe diskutimi për çështjet si vijojnë:

a. *Shqyrtimi i numrit total të monitorueseve të kontraktuar dhe përcaktimi i numrit për secilin subjekt zgjedhor sipas peshës së veprimtarive që kanë;*

- Monitorimi i veprimtarisë zgjedhore të subjekteve prihet nga diskutimi mbi kapacitetin vëzhgues. Ky kapacitet vlerësohet së pari në raport me numrin total të ekspertëve dhe më pas kriteret për përcaktimin e këtyre ekspertëve sipas subjekteve.

b. *Shqyrtimi se cili do të jetë angazhimi kohor dhe metodologjia e trajtimit financiar të monitoruesve në varësi të punës së kryer;*

- Angazhimi kohor i ekspertëve është i ndërlidhur me kapacitetin vëzhgues dhe pagesën e tyre, që është edhe incentiva e angazhimit të tyre.

Ekspertë të ndryshëm kanë ngritur shqetësimin se në proceset e kaluara metodologjia e përdorur për t'i paguar ka qenë e paqartë dhe përcaktimi i pagesës nuk ka qenë i njëjlojtë për të gjithë.

c. *Shqyrtimi i ndërveprimit të ekspertëve monitorues me institucionet publike përgjegjëse në rregullimin e fushatës;*

- Eksperti monitorues në analizë të tërë mekanizmit ligjor gjykohet se do të duhet të shihet në funksionalitet njësoj me auditin teknikien për listat e zgjedhësve.

Ashtu si auditit teknikien i është atribuar e drejta ligjore prej titullari të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile për të kërkuar informacion, e njëjta qasje do të duhet të kihet edhe me ekspertët monitorues në raport me institucionet përgjegjëse, si për shembull Policia e Shtetit, Bashkitë, apo të tjerë.

d. *Shqyrtimi se cila strukturë e KQZ-së është përgjegjëse për punën e ekspertëve monitorues;*

- Ekspertët monitorues nuk mund të konsiderohet si një shërbim i kontraktuar së jashtmi dhe ndaj të cilit të pritët në fund një produkt.

Puna e kryer nga monitoruesit duhet të ndiqet nga një strukturë e veçantë e KQZ-së në raport në ndjekjen e punës së kryer, si dhe në raport me asistimin e ekspertëve për problematikat që mund të hasin. Për më tepër, një strukturë vendore e KQZ-së që mund të përfshihet dhe asistojë në këtë drejtim janë Zyrat Rajonale të saj.

e. *Shqyrtimi i ciklit kohor të raportimeve monitoruese të ndërmjetme dhe atij final;*

- Edhe një herë parashtrahet që procesi i monitorimi nuk do të duhet të konsiderohet si i konkluduar me hartimin e vetëm një raporti përfundimtar.

Nevojitet që raportimi të kryhet sipas një cikli kohor të arsyeshëm dhe të mundshëm, në funksion të transparencës në raport me qytetarët, mundësisë së ndjekjes nga KQZ-ja të punës së monitoruesve dhe si një sistematikë që do të lehtësojë vetë raportin final të ekspertëve. Gjithashtu një mënyrë e tillë raportimi ofron mundësinë për nxitjen dhe

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailing address:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

përfshirjen në monitorim të fakteve të jashtëligjshme të denoncuar apo raportuara nga qytetarët apo aktorë të tjerë. Nga ana tjetër, raportimi kohor konsiderohet edhe si një rrethanë e rëndësishme për të ndihmuar në kontrollin e ekspertëve kontabël.

f. *Shqyrtimi i publikimit të raporteve monitoruese të ndërmjetme dhe atij final;*

- Mekanizmi i kontrollit të veprimtarisë financiare të subjekteve zgjedhore duhe të paraprihet domosdoshmërisht nga procesi i transparencës.

Kjo transparencë jo vetëm ndihmon kontrollin, por mbart rëndësi të madhe në ndërgjegjësimin e qytetarëve dhe në rritjen e besimit të tyre ndaj procesit zgjedhor. Një qasje e tillë, e zbatuar në afate kohe të arsyeshme, psh. 1 javore sikundër ka qenë më parë, në ndjekje të fushatës zgjedhore implikon drejtpërdrejtë transparencën e vazhdueshme që duhet të shoqërojë tërë fushatën zgjedhore në të gjithë elementët përbërës të saj.

g. *Shqyrtimi i penaliteteve dhe i detyrimit për bashkëpunim në rastet kur subjektet zgjedhore nuk i përgjigjen ekspertëve monitorues;*

- Në rastet kur subjektet zgjedhore nuk i përgjigjen ekspertëve monitorues në informacionin e kërkuar, duhet të parashikohen penalitete të ekzekutueshme menjëherë dhe në rast të vijmësisë në sjellje të parashikohet rritja e penaliteteve.

h. *Shqyrtimi i metodologjisë së raportimit sipas kandidatëve të listave shumëmërore;*

- Në kuadër të ndryshimeve të fundit të Kodit Zgjedhor, objekt i kontrollit të veprimtarisë financiare do të jenë edhe kandidatët e listave shumëmërore.

Kjo kërkon të reflektohet edhe në metodologjinë e raportimit të monitoruesve të cilën do të duhet të përgatisë KQZ-ja në bashkëpunim me ekspertët monitorues.

Përfshirja e kandidatëve në raportim e vështirëson procesin e monitorimit, duke nxitur kështu kërkimin për gjetjen e një model raportimi të mirëdetajuar, më të përmirësuar se formatet e raportimit për kryetarët e bashkive gjatë zgjedhjeve të 2019-ës, si dhe shqyrtimin e mundësisë për një numër më të lartë monitoruesish.

* * *

Në raport me [Pyetjen 1](#)⁹ dhe [Pyetjen 2](#)¹⁰, KRIIK shprehet kundër ndarjes së punës së ekspertëve monitorues mbi bazën e zonave gjeografike.

Mbi propozimin e paraqitur, KRIIK shprehet se nuk gjen arsye në raport me efikasitetin e ndarjes gjeografike të monitorimit. Për më tepër konsiderohet se ky sugjerim është jofunksional në monitorimin e fushatës zgjedhore.

⁹ Pyetja 1: Emërimi i monitoruesve

Në zgjedhjet e kaluara, KQZ-ja ka emëruar ekspertë monitorues për të bërë monitorimin e një subjekti të caktuar zgjedhor. Një qasje alternative do të ishte që monitoruesit të mbulonin një zonë të caktuar gjeografike dhe jo një subjekt të caktuar zgjedhor. Kjo do t'i mundësonte monitoruesve të kuptonin më mirë fushatën në një zonë të caktuar dhe të mbikëqyrnin keqpërdorimin e mundshëm të burimeve publike në baza gjeografike.

A mendoni se do ishte një qasje më e mirë emërimi i monitoruesve për të mbuluar një zonë të caktuar gjeografike, sesa monitorimi i një subjekti të caktuar zgjedhor?

¹⁰ Pyetja 2: Monitorimi gjeografik

Sipas mendimit tuaj, a do të ishte më efektiv monitorimi i zonës gjeografike në bazë qarku apo bashkie (ose njësie bashkiake në rastin e Bashkisë Tiranë)?

1. Qarku

2. Bashkie ose njësie bashkiake (në rastin e bashkisë Tiranë)

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailing address:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Decentralizimi dhe parcializimi i informacionit konsiderohet si një rritje e volumit të punës, përveçse lë vend edhe për mundësi spekulimi gjatë zbatimit në praktikë.

Ndjekja e një subjekti zgjedhor, sikundër është përvijuar deri më tani, nga një ekspert apo më shumë, siguron kanale komunikimi më të qendrueshme dhe më të lehta në komunikimin e ndërsjellë midis ekspert/it/ëve dhe subjektit zgjedhor.

Kjo qasje paraqitet më objektive pasi vendoset një marrëdhënie me e fokusuar dhe e thelluar, duke racionalizuar energjite, shmangur relativizimin e problematikave dhe funksionalizuar më mirë elementë të tjerë ndihmës që mund të përdoren. Gjithashtu dhe raporti mund të konkludojë në një vlerësim përfundimtar më të plotë.

Në rast se raporti përfundimtar për një subjekt do të përgatitet nga minimalisht 12 apo më shumë ekspertë, raporti përfundimtar do të ketë nivele thellimi dhe qasjesh të ndryshme, volumni i të dhënave do të ishte i lartë çka bie në kundërshtim edhe me kërkesën¹¹ e Kodit Zgjedhor, e të tjera problematika në zbatim. Në rezultante të së tërë teksti përfundimtar do ishte praktikisht jo konkludues dhe jo efikas për auditin kontabël.

Gjithashtu, duke marrë në konsideratë funksionimin e centralizuar të partive politike, një skemë e tillë do të ishte barrë edhe për vetë subjektet zgjedhore, pasi secila prej tyre do të kishte së paku 12 kanale komunikimi sipas qarqeve, apo akoma edhe më shumë në rast caktimi të bashkisë si zona bazë gjeografike.

* * *

Në raport me **Pyetjen 3**¹² dhe **Pyetjen 4**¹³, fillimisht KRIIK parashtron katër tematika që pararendin pyetjet.

Nevojitet të paracaktohet se cilat do jenë: ekspertiza e monitoruesve, koha e angazhimit të monitoruesve, numri i monitoruesve dhe trajtimi financiar i tyre. Gjykohet se këto katër çështje e implikojnë pashmangshmërisht përcaktimin e objektit të veprimtarisë monitoruese.

Ndonëse shprehen rezerva për ekspertizën e ekspertëve kontabël në monitorimin e kryer deri më tani, pranohet se këta profesionistë janë më të afërt në objektin e punës së tyre me monitorimin e veprimtarisë zgjedhore.

¹¹ Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Ligji Nr. 10019, datë 28/12/2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 92/4, pika 4, “*Monitorimi nuk kërkon që monitoruesit të llogarisin shpenzimet totale për fushatë zgjedhore nga subjekti zgjedhor ose variablat e ndryshme financiare, që kërkojnë mbledhje të metadatave të zgjeruara.*”

¹² Pyetja 3: Monitorimi i subjekteve zgjedhore
Sipas nenit 92/4 të Kodit Zgjedhor, KQZ-ja do të përcaktojë me udhëzim kriteret për përzgjedhjen e monitoruesve dhe objektin e monitorimit.

Sa i përket respektimit të detyrimeve të fushatës zgjedhore nga subjektet zgjedhore, a jeni dakord se objekti i monitorimit për zgjedhjet e ardhshme parlamentare duhet të përfshijë:

- a) Numrin e zyrave zgjedhore në lagje*
- b) Afishimin e materialeve propagandistike*
- c) Veprimtaritë zgjedhore (p.sh., mitingjet, eventet, takimet)*
- d) Reklamën e paguara (p.sh., posterat, gazetën, televizionin, media sociale dhe online)*

¹³ Pyetja 4: Veprimtari të tjera monitoruese
Cilat veprimtari të tjera lehtësisht të verifikueshme të financimit të fushatës për subjektet zgjedhore, nëse ka të tilla, duhen monitoruar?

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailing address:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Megjithatë është i nevojshëm dhe kërkohet një trajnim nga institucioni për kuadrin ligjor zgjedhor, për çështjet zgjedhore dhe për pritshmëritë apo kërkesat mbi veprimtarinë monitoruese.

Kjo mund të arrihet në ndërveprim me IEKA-n duke ndërtuar një proces rritjeje të vazhdueshme të kapaciteteve për përgatitjen e një trupe të qendrueshme dhe plotësisht në kualifikuar për monitorim.

Angazhimi kohor, trajtimi financiar dhe numri total, të treja paracaktojnë kërkesat që institucioni i KQZ-së mund të ketë ndaj këtyre monitoruesve. Nëse ekspertët mund të ruajnë angazhime të tjera gjatë punës monitoruese, kanë një trajtim financiar që është inkurajues për angazhim tërësor apo numri i monitoruesve është i limituar, procesi monitorues do rezultojë subjektivisht dhe objektivisht i pa arrirë apo edhe i pamundur.

Duke qenë se Kodi Zgjedhor nuk kërkon nga monitorimi një mbulim tërësor të veprimtarive, nevojitet që së paku mbulimi i objektit që monitorohet të jetë tërësor.

Nëse ekspertit do t'i kërkohet monitorimi për shembull i takimeve elektorale, monitorimi në përfundim të procesit duhet të prezantojë gjetje që përkojnë maksimalisht përsa ka ndodhur në nivel kombëtar. Kjo do të thotë që, potencialisht, Policia e Shtetit të njoftojë në kohë reale për të tërë lejet e dhëna apo partitë të depozitojnë materialet filmike të veprimtarive.

Kjo mënyrë e organizimit të procesit monitorues, duke konkluduar në një monitorim integral, së paku do të ofronte një transparencë të plotë qoftë edhe vetëm për një apo disa kategori të shpenzimeve apo zërave, sikundër paraqiten në formatet e raportimit financiar të subjekteve zgjedhore të miratuara në 2019, formate që nevojiten të përmirësohen edhe më tej duke reflektuar mangësitë e evidentuara më parë.

Nga ana tjetër, ky monitorim dhe vlerësim financiar do t'i vinte në ndihmë edhe audituesve financiarë në vlerësimin e zërave në vetëdeklarimet e subjekteve zgjedhore.

* * *

Në raport me [Pyetjen 5¹⁴](#), KRIIK ofron një perspektivë të anasjelltë nga sa sugjerohet nga pyetësi dhe përsa është zbatuar në dy proceset e fundit zgjedhore.

Argumentohet se ekspertët monitorues janë ekspertë të kontraktuar për një detyrim ligjor të rëndësishëm. Për këtë arsye komunikimi i tyre me subjektet zgjedhore nuk duhet të jetë një marrëdhënie sikur të ishin duke kryer census.

Marrëdhënia e monitoruesve me subjektet zgjedhore duhet të jetë një marrëdhënie ligjore, me të drejta dhe detyrime të mirëpërcaktuara.

Në qasjen e KRIIK, subjektet zgjedhore duhet të jenë ato që duhet të kenë barrën e informimit paraprakisht të monitoruesve për veprimtaritë e tyre elektorale. Madje edhe strukturën e ngritur posaçërisht në KQZ, nëse do të ngrihet një e tillë.

¹⁴ Pyetja 5: Teknikat e monitorimit

Cilat teknika do t'i konsideroni më efektive për monitorimin e respektimit të detyrimeve të fushatës nga subjektet zgjedhore? (Zgjidhni alternativat që mendoni)

- Vizitat në zyrat zgjedhore*
- Intervistat*
- Vëzhgimi i veprimtarive të fushatës*
- Ndjekja e mbulimit të fushatës zgjedhore në media/online/media sociale*
- Fotografimi, filmimi ose mbledhja e provave të tjera të prekshme*
- Tjetër*

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailing address:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

E njëjta qasje duhet të vlejë për Policinë e Shtetit që të informojë monitoruesit për lejet e dhëna për takime, apo për Bashkinë në dhënien e lejeve për hapjen e Zyrave Zgjedhore.

Detyrat e ekspertit monitorues do të ishin që të dokumentonte dhe raportonte rastet kur evidentoheshin aktivitete të pa raportuara dhe se sa do të ishte kostoja e përlllogartur për secilën prej këtyre veprimtarive të pa raportuara.

Nga ana tjetër, arsyetohet se ky njoftim prej subjekteve zgjedhore, në një afat të arsyeshëm psh. javore, nuk do të përbënte aspak një barrë të shtuar ndaj tyre, përkundrazi. Kjo do të ndihmonte edhe vetë ato në hartimin e vetëraportimit financiar, në përmbushje të detyrimeve fiskale e ligjore.

Këto subjekte zgjedhore, si çdo entitet tjetër përpara ndërmarrjes së një veprimtarie, përpara nisjes së fushatës elektorale ndërtojnë një program të plotë dhe një plan veprimi të detajuar, i cili ndonëse dinamik në çdo rast përbën një kornizë veprimtarish. Kësisoj raportimi i këtyre veprimtarive tek monitoruesit apo tek struktura përkatëse në KQZ, nuk do të përbënte asnjë barrë të pa arsyeshme apo penguese.

* * *

Në raport me **Pyetjen 6**¹⁵ dhe **Pyetjen 7**¹⁶, vlerësohet se objektet e referuar janë tërësisht jashtë kapaciteve, mundësive dhe ekspertizës së çdo lloj trupe monitoruesish që mund të ngrihet enkas me këto objektiva.

Kërkesat e përmendura në këto pyetje, janë detyrime që i përkasin drejtëpërdrejtë institucionit të KQZ-së dhe nuk mund t'iu kërkohej monitoruesve në asnjë rast.

Duke iu ngarkuar një objektiv të tillë monitoruesve, përpos detyrave të tjera të përmendur më lart, praktikisht iu ke bërë të pamundur një kontribut real dhe efikas të tyre.

¹⁵ Pyetja 6: Shpërdorimi i burimeve shtetërore

Sipas nenit 92/4, pika 2 të Kodit Zgjedhor, KQZ-ja do të përcaktojë fushat e shpërdorimit të burimeve publike që monitoruesi i fushatës duhet të monitorojë.

A jeni dakord se kriteret e mëposhtme duhen marrë parasysh në përcaktimin e këtyre fushave?

a. *Masa e keqpërdorimit të burimeve publike: kjo do të thotë të përqendrohesh më shumë në veprimtaritë me ndikimin më të madh, për shembull, në ndërtimin e rrugëve/spitaleve të reja, dhe më pak në veprimtari të tilla si p.sh. në printimine broshurave.*

b. *Ndikimi i mundshëm në zgjedhjet e lira: kjo mbulon zëra me kosto më të ulët, por që kanë ndikim të konsiderueshëm, p.sh. përdorimi i llogarive në media sociale për të promovuar partinë/kandidatët në detyrë ose për të shënjestruar opozitën.*

c. *Veprimtari e cila është e dokumentueshme: kjo do të përfshinte veprimtarinë që lë gjurmë, p.sh. kontrata të përkohshme/falje borxhi, dhe jo udhëzimet verbale për punonjësit.*

d. *Ndryshimet në praktikë/devijimi nga praktika e mëparshme: kjo do të përfshinte ndryshime në veprimtaritë shtetërore pak para zgjedhjeve (në krahasim me veprimtarinë që është ndoshta e dyshimtë, por e vazhdueshme pavarësisht nëse ka zgjedhje të ardhshme).*

e. *Veprimtari që është qartësisht e paligjshme, sesa veprimtari ligjshmëria e së cilës mund të vihet në diskutim (p.sh. zonat gri).*

¹⁶ Pyetja 7: Monitorimi i shpërdorimit të burimeve publike

Për zgjedhjet parlamentare 2021, KQZ-ja po konsideron ta përqendrojë monitorimin e fushatës në llojet e mëposhtme të shpërdorimit të burimeve publike:

a) *Punësimet në institucionet apo entet publike;*

b) *Lancimi i projekteve të reja infrastrukturore, p.sh. ndërtimi i rrugëve, spitaleve etj., që nuk janë të parashikuara në planet shtetërore/vendore të zhvillimit apo plane të tjera;*

c) *Rritja e pagave dhe përfitimeve të tjera sociale;*

d) *Amnistia fiskale, ulja ose heqja e taksave;;*

e) *Përdorimi i ndërtesave dhe mjeteve publike.*

A mendoni se këto janë veprimtari lehtësisht të verifikueshme dhe të përshatshme për të qenë objekt i monitorimit të fushatës?

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailing address:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Në një këndvështrim më të plotë do të rezultojë që monitoruesve do t'iu kërkohet të monitorojnë çdo gjë përciptazi dhe, kësajsoj, në realitet do të konkludojnë duke monitoruar asgjë domethënëse dhe me vlerë të përdorshme.

Ajo që nxitet dhe mbështetet me forcë është ngritja e një strukture permanente dhe specifike në KQZ, e cila të ndjekë në vijimësi sjelljen institucionale në raport me proceset zgjedhore.

Kjo strukturë më qasje ndërinstucionale mund të jetë e njëjta e ngarkuar me:

- a. shqyrtimin te ankesave të mbërritura nga të tretë për fakte të jashtëligjshme;
- b. ndërveprimin me nëpunësit ndërlidhës në institucionet publike;
- c. ndërveprimin me Komisionerin e Shërbimit Publik;
- d. ndërveprimin me Komisionerin Kundër Diskriminimit;
- e. ndërveprimin me Avokatin e Popullit.

* * *

Në përfundim, në kuadër edhe të transparencës, KRIIK sheh si mjaft të nevojshme dhe shpreh kërkesën ndaj Institucionit të KQZ-së për publikimin e të gjithë kontributeve të mbërritura në funksion të këtij pyetësi, në përgjigje të Ftesës së bërë publikisht edhe në faqen e internetit të KQZ-së.

Gjithashtu, nxitet Institucioni të ndërmarrë zhvillimin e një seancë konsultative mbi kontributet e mbërritura nga organizatat e shoqërisë civile apo edhe aktorë të tjerë.

KRIIK shpreh gatishmërinë e tij për t'u përfshirë apo për të përcjellë kontributin e tij në veprimtaritë e ardhshme që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve do të gjykojë të përshtatshme.

Tiranë, më 24 Nëntor 2020!

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailing address:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania